REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 869/20
Datë/Datum 13.11.20

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksper. shqyrtues dhe nënshkrimi:	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës:*
Ermal Shala:	02/11/2020	10/11/2020	*869/20*

1. BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 30.10.2020, **OE "Dona-Impex" SH.P.K. – Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **869/20**, kundër njoftimit për shpërblim me kontratë dhe refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së, për aktivitetin e prokurimit numër **"KEK-20-3880-1-2-1"** nr. nrendshë **"KEK-20-260-121"**, me titull **"Furnizim me aparat saldimi MIG 500A"**, iniciuar nga **AK – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, vlerë e mesme, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **60,000.00€.**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:
Data e përgatitjes së njoftimit për kontratë: 23.07.2020
Afati i fundit për dorëzim të ofertave: 17.08.2020 ora 12:00
Vendimi i AK-së dhe letrat standarde: 16.10.2020
Kërkesa për rishqyrtim pran AK: 21.10.2020
Pezullimi i Aktivitetit: 22.10.2020
Përgjigja në kërkesën për rishqyrtim: 22.10.2020
Ankesa në OSHP: 30.10.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të LPP-së, Ekspertet Shqyrtues ka shqyrtuar pretendimet ankimore.

2. DISPOZITAT E SHKELURA NGA AK DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

OE "Dona-Impex" SH.P.K. – Prishtinë, pretendon se gjatë kësaj procedure të prokurimit, nga ana e AK-së janë shkelur këto dispozita të Ligjit 04/L-042; 04/L-237; 05/L-068; dhe ligjit 05/L-092.

1. AK ka shkelur Neni 1, Qëllimi. të LPP të amandamentuar,
2. AK ka shkelur Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti - të LPP të amandamentuar,
3. AK ka shkelur Nenin 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve te LPP të amandamentuar,

amandamentuar,
4. AK ka shkelur nenin 72 të LPP të amandamentuar dhe ka shkelur nenin 39 te RRUOPP-se

I paknaqur ne vendimin e Autoritet Kontraktues te dates 21.10.2020 mbi refuzimin e Kerkeses sone per Rishqyrtim si te pabazuar ne lidhje me eliminimin tone nga konkurrenca e metutjeshme ne kete procedure te prokurimit "Furnizim me aparat saldimi MIG 500 A" me nr.te prokurimit:KEK-20-3880-1-2-1 nr.brend. KEKC-20-260-121 ne afatin e lejuar ligjor paraqese ANKESE pran OSHP-se per shkak:

- • Te konstatimit te gabuar te gjendjes faktike,
- • Aplikimit te gabuar te te drejtes materiale.

Autoriteti kontraktues me daten 16.10.2020 ne portalin e-prokurimi ben njoftimit ne lidhje me Vendimin dhe letrat standarde per projektin e lartepermendur ku ne mes tjerash edhe kompania e jone pranon letren standarde per tenderuesin e eliminuar me çka vlersojme se AK ka bere shkelje te Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L- 042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, edhe ate sipas pretendimeve te cekura ne vijim me te cilat ne kemi bere edhe kerkese per rishqyrtim:

Pretendimi 1. Neni 1, Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, por ne këtë rast Autoriteti Kontraktues nuk e ka arritur qellimin e ketij tenderi duke mos rrespektuar ne tersi dizpozitat e LPP-së, dhe duke mos i respektuar ne mënyrën me efikase fondet publike.

Pretendimi 2.- Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti,- Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Bazuar ne kete fakt AK ka rekomanduar për shpërblim me kontratë OE 'NTP B&L seli ne Prishtinë, i cili ka qene me i shtrejt se kompania e jone per me shume se 4,221.80€, dhe kompanin tone e eliminon me arsyetim se jemi te papergjegjshem.

Pretendimi 3: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.- AK ka shkelur nenin 59 te LPP-se pasi qe edhe pse ne kemi qene plotesisht te pergjegjshem nuk na cileson si te tille dhe shperblen me kontrate nje OE I cili ka qene I pesti ne renditje dhe ka qene me I shtrejte me çmim me shume se 4,221,80 € se sa kompania e jone . AK ka shkelur nenit 59 të LPP-së pasi që edhe pse ne kemi qenë plotësisht të përgjegjshëm nuk na cilëson si te tillë per cka edhe na eliminon nga konkurrenca e metutjeshme duke rekomanduar me shperblim me kontrate OE 'NTP B&L seli ne Prishtinë. Nga këtu shihet se AK nuk ka respektuar si duhet nenin 59.4 të LPP i cili thotë: *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet-klarifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve,* ndersa oferta e jone ka qene e plotesuar saktesisht sipas kerkesave te DT perkatesisht specifikacionit teknik te pergaditur nga AK. Ka mundur te kete ndonje devijim minor ose ndonje gabim teknik qe per te njejtin AK ka mundur ta sqaroj shume lehte sepse kete veprim ia lejon neni 59.4 por edhe neni 72 i LPP-se.

Elementet për të cilat AK na ka cilësuar si të papërgjegjshëm nuk qëndrojnë. Në rastet kur AK ka pasur paqartësi rreth tyre, është dashur të na kerkoj sqarime përmes rrugës ligjore ku me pas ne do të ofronim informata të mjaftueshme për ta bindur AK-në që oferta jonë është e

kompletuar dhe i plotëson të gjitha karakteristikat e kërkuara. Edhe ndonjë gabim teknik që kanë mundur të rrjedh AK do duhej t'a trajtoj sipas nenin 59.4 (i, ii) sepse ne vetë kemi nënshkruar deklaratën e specifikimeve teknike ku jemi deklaruar që liferimet do ti bëjmë plotësisht në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe aneksit 1, prandaj AK nuk ka respektuar nenin 59 të LPP lidhur me vlerësimin dhe krahasimin tenderëve dhe njëherit edhe konsiderohet shkelje e këtij neni.

Per ta bere me te qartë këtë pretendim, ne vazhdim po japim sqarimin e nevojshem per secilin pretendim qe AK e ka kontestuar gjate vleresimit te tedereve:

- **Konstatimi i 1. i AK** -Ne Letrten Standarde per tenderuesin e eliminuar si dhe vendimin mbi refuzimin e Kerkeses per rishqyrtim se kompania e jone eshte ne kundershtim me Nenit 4 te FTD nuk qendron **dhe i pabazuar** pasi ne kete nen shkruan: *Variante* autorizohen: Po Jo *"Specifikimet minimale që duhet të përmbushen nga ndonjë variant janë të shënuara në specifikimet teknike të parashtruara në këtë dosje të tenderit, shih Aneksin 1, ndersa"per kete ju informojme se* kompania e jone nuk ka ofruar specifikacion teknik me variante. Kompania e jone ka ofruar deklaraten qe i permbush kriteret e kerkuara sipas Anesksit 1 te FTD-se si dhe kemi nenshkruar dhe vulosur Aneksin 1 te FDT dhe per keto kritere te kerkuar ne kemi ofruar produktin e prodhuesit **MIGATRONIC -Danimark** se bashku me pjese katalogu te nenvizuar produktin **OMEGA 550** si dhe kemi ofruar **certifikaten 9001:2015 kerkesa e pare e AK ISO.** (***shtoce 1.***-*pjesa e katalogut qe kemi ofruar*). Devijimi minor i cili ka qene (ka ndodhe) eshte te Pershkrimi i çmimeve per shkak te nje gabimi teknik qe eshte shkruar Suedi a eshte dashte te shkruhet Danimark. Ndersa tenderit i jane bashkangjitur te gjitha shenimet e prodhuesit nga Danimarka- Migatronic si ISO Certifikata 9001:2015 dhe katalogu i aparatit per saldim i prodhuesit Migatronic me parametrat e nenvizuar gjithashtu edhe deklarata qe jane te permushura specifikat teknike ashtu siq eshte kerkuar ne nenin 3 te FDT. Per kete paqartesi AK ka mundur ta sqaroni shume lehte sepse kete veprim ia lejon neni 59.4 por edhe neni 72 i LPP-se. Produkti i ofruar sipas Katalogut dhe parametrave qe kane qene ne fazen e ofertimit jane parametra te cilit obligatisht duhet qe te plotesohen nga ana e OE pasi ne te kunderten AK nuk e pranon fare mallin -produktin nese liferimi nuk eshte sipas katalogut te ofruar me tender. Prandaj devijim eshte shume minor ne krahasim me rendesine . Prandaj ky pretendim i AK eshte i paqendrueshem pasi ne nuk keni ofruar produkt me varianta mirepo ka rrjedh nje gabim teknik i cili eshte minor.

- **Konstatimi i dyte i AK** eshte i pa qendrueshem **dhe i pabazuar** pasi AK ne specifikacionin teknik Aneksi 1 i FDT ka shkruar decidivisht per Karakteristikat e dorezes per saldim (pistolj hladeni tecnoscu) : "Ofertohet fuqia punuese me CO me gaz te perzier 520 A e kerkohet fuqia pun. me CO_2 (450-650)A dhe me gaz te perzier (400-600)A. Kompania e jone per kerkesen "-te perballoj fuqine punuese me CO_2 **(450-650)A** ka ofruar katalogun me parametra **CO_2 , 60% dhe CO_2, 100%** me parametrin **560A** i cili eshte mbrenda kufijve - intervaleve te kerkuara, gjithashtu edhe per kerkesen me gaz te perzier **(400-600)A"** kemi ofruar katalogun per parametrat e kerkuar **(mesavina 60% dhe mesavina 100%)** parametrin **520A** i cili parameter eshte mbrenda kufijve te kerkuar ne FTD. AK kete specifike e ka specifikuar me karakteristika teknike me intervale ndërsa pajisja jonë që e kemi ofertuar është brenda atyre intervaleve te kerkuara me intervalin decidiv te theksuar. Bazuar ne kete konstatimi i komisionit **eshte i paqendrueshem dhe i pabazuar.**

- **Konstatimi i trete i AK.-** Ndersa sa i perkete konstatimit tjeter vijues ku AK ka shkruar *"Ofertohet rashladna tecnost, bar-$_o$C -l/min (1.2-60-1.75)", ndersa kerkohet min2.8l/min ne anex-1 te Dosjes tenderit"* .eshte **komplet i paqendrueshem dhe i pabazuar.** Para se gjithash me kete konstatim AK ka bere perzirje te parametrave ku per pjesen te cilen e kan shkruar *rashladna tecnost, bar-$_o$C -l/min (1.2-60-1.75)"* eshte kerkese per aparat saldimi ndersa AK i referoheni kerkeses e cila eshte te Karakteristikat e dorezes se saldimit -*Mundesia e qarkullimi te lengut ftohes minimum 2.8 l/min.* Pavaresisht kesaj ne kemi sqaruar edhe ne kerkesen per rishqyrtim si dhe bazuar edhe ne çasjen te dokumentacioni i OE te rekomanduar

per kontrate (NTP "B&L) verejm se OE i rekomanduar per kontrate per kriterin e kerkuar prej 2.8 l/min. ka ofruar katalogun me parametrin **2.8 l/min** mirepo ky parameter i ofruar eshte me presion **prej 2-4 bar** (***shtojce -2-*** *katalogu i OE*) ndersa katalogu i prodhuesit tone te cilin e kemi ofruar ne tender decidivisht shkruan: " **Min protok tecnosti pri pritisku 1 bar =1 l/min**" (shtojce pjese e akatalogut) ndersa nga shkresat te cilen na ka derguar prodhuesi nepermjet distributorit ton shkruan qe presioni ne **3 bar qarkullimi arrin deri ne 8 l/min.**(***shtojca 3***.- *shkresa e Distributorit dhe prodhuesit si dhe tabelen e presionit*). Nga sqarimet e prodhuesit presioni rritet ne menyre automatike varesishte prej nevojes se ftohjes. Qarkullimin qe kan ofruar ne katalog eshte per presion ne 1 bar e jo ne presion me te larte. Ne momentin qe fillon me saldu fillon me u nxe paisja atehere automatikisht rritet edhe qarkullimi. Aparati i llojit te tille ne kushte pune zakonisht presioni arrine deri ne 3 bar dhe mund te kete qarkullim te ujit deri ne 8 l/min. Kjo nenkupton se paisja e jone ne 1 bar ka qarrkullimn 1 l/min ndersa ne 3 bar mund te arrin deri 8 l/min. Prandaj aparati i jone ne 2 bar i ka 4.5 l/min apo me 1.6 bar arrin vleren e 2.8 l/min. Sipas LPP-se dhe interpretimeve te KRPP-se, çdo here kur artikulli eshte me kualitet te barabart ose me kualitet me te larte, konsiderohet si kusht i pranuar. Bazuar ne kete del se asryetimi i kontestimit te ketij artikulli nga ana e AK-se eshte i pabazuar dhe i paqendrueshem. Komisioni i vleresimit i AK qe eshte dashte te jete profesional ne ate moment kur e ka verejt ne katalog se paisja e ofruar ne nje bar presion ka pas qarkullim 1 liter/min atehere automatikisht eshte nenkuptuar qe paisja ne presion me te larte do ta kete edhe qarkullimin me te larte. Inxhinjeret e prodhuesit kane qene te befasuar me konstatimet e komisionit vleresues te AK pasi çdo inxhinjer eshte dashte me dite presionin ne nje bare dhe presioni ne 2 e me teper bar sa kemi rritje te qarkullimit te ujit.

- Me rastin e dorezimit te tenderit kompania e jone ka dorezuar deklaraten e Specifikacionit Teknik te kerkuar ne Nenin 3 te FDT ku jemi deklaruar se furnizimet e ofruara nga kompania e jone i permbushin kerkesat e detyrueshme teknike dhe se oferta e jone eshte plotesishte me kerkesat sipas Aneksit 1 gjithashtu jemi deklaruar qe kompania e jone pranon mundesine e sanksioneve ne perputhje me kushtet e kesaj dosje te tenderit dhe ligjeve ne fuqi, gjobave dhe demeve nese OE ne fjale me qellim per shkak pakujdesise ose te ndonje arsye tjeter dorezon produkte tjera jo ne perputhje me kerkesat e Aneksit. Bazuar ne kete produktin e ofruar ne jemi te detyruar dhe deklaruar qe do ta furnizojme sipas katalogut te ofruar me ofertre si dhe me ISO standardin e kerkuar. **Migatronic-Danimark.**

Pretendimi 4: AK ka shkelur nenit 72 të LPP-së dhe 39 te RRUOPP-se pasi që edhe përkundër asaj që ka pasur ndonje paqartësi gjatë procesit të vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, ai nuk e ka shfrytëzuar mundësin që ja ofrojne keto dy dispozita te ligjit dhe Rregullores. Neni 72 shumë qartë e tregon për AK- se:

Edhe neni 39 i RRUOPP-se i tregon qarte AK-se se si duhet vepruar kur ka paqartesi rreth ndonje tenderi apo dokumentacioni pjese perberes te tij. Po ashtu shume qarte i tregon se si duhet vepruar me dokumentacionet qe objektivisht munden te verifikohet nga AK e qe nuk perbejne asnje ndryshim material apo kuantitativ te tenderit qe sqarohet.

Per kete arsye mendojme se AK perkatesisht komisioni vleresues ka shkelurn nenin 72 te LPP-se dhe nenin 39 te RRUOPP-se me rastin e vleresimit, sqarimit dhe krahasimit te tendereve. Bazuar në këtë shihet qartë se AK nuk ka vepruar drejt në sqarimin e çështjes e cila do kontribuonte shumë te shfrytëzimit të parasë së AK-së në mënyrë efektive. Kjo edhe e ka shtyre AK drejt shkeljes së plotë të nenit 72 të LPP-së.

- Ne rastin konkret AK eshte dashur te kerkoj sqarime sepse ne baze te konstatimeve te tije shihet se nuk i ka pasur te qarta disa parametra dhe i ka refuzuar pretendimet e tilla si te pabazuara. Bazuar ne kete del qe veprimi i AK-se bie ne kundershtim te plote me nenin 108/A i LPP-se i cili shume qarte e sqaron se si duhet vepruar gjate dhe pas shqyrtimit te Kerkesave per Rishqyrtim.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET ANKIMORE

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1. Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 Neni 65. 2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit. 3. Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – kopje e noterizuar .- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit.	1. Një deklarata nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise, pika 2, dhe 3 do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet..
Përshtatshmëria profesionale	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; 2. Regjistrimi i TVSH; ne vendin e themelimit 3. Regjistrimi i numrit fiskal	1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend Kopja e certifikatës së biznesit); 2. Kopja e certifikatës TVSH-se; 3. vKopja e certifikatës numrit fiscal
Kapaciteti teknik dhe professional	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1. Çertifikate te produktit ne lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet 2. Katalogje te produkteve	1. Certifikatë e kualitetit nga prodhuesi ISO 9001;2015 2. Dokumentacioni autentik i prodhuesit si pjese te katalogut nga prodhuesi di me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni. Ne katalog pjese te katalogut dhe apo vizatim sipas specifikimeve teknike te kërkuara te nënvizohen artikujt për pozicionet e kërkuara

4. RAPORTI I KOMISIONIT RI-VLERËSUES

N/A

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË ANKESËS

Përgjigje në pretendimet ankimore te OE ankues

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit në detaje të pretendimit të OE ankues, analizimit të DT, NJK, specifikacionit teknik, përshkrimi i çmimeve vendimeve të AK, kërkesave për sqarime dhe fakteve të kësaj ekspertize mendon që AK ka vepruar në kundërshtim me nenët 1, 6, 59, 72 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1 dhe 2: Nenin 1 dhe Neni 6

Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE "Dona-Impex" SH.P.K. – Prishtinë lidhur me anulimin e ofertës së tyre nga AK - Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.. për cimimin e ofertës sqaron se AK ka vepruar në kundërshtim me RROUP dhe LPP. Andaj pretendimi ankimor i OE se ka dorëzuar ofetën me cmimin më të ulët në vlerë 4,221.80 € ndërsa AK në kundërshtim me nenin 1 dhe 6, të LPP ka shpallur fitues OE i cili është me çmimin më të lartë. Ky pretendim **është i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin ankimor 3 dhe 4: Neni 59 dhe Neni 72

Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE "Dona-Impex" SH.P.K. – Prishtinë, sqaron se AK dhe komisioni vlerësimit kanë vepruar në kundërshtim me Nenin 59 pika 2 dhe 4 në këtë procedurë të prokurimit, AK - Korporata Energjetike e Kosovës sh.a ka vendosur si kriter në NJK dhe DT se Autoriteti Kontraktues do ti jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**, AK dhe komisoni vlerësimit gjatë vlerësimit është dashur që ta vlerësojn ofertën e OE ankues sipas nenin 59, dhe për informacione dhe materialet të cilat komisoni nuk ka mundur ti vlerësoj, si në rastin e vendit të prodhuesit (Danimarke – Suedi). Ne të gjitha katalogjet e dorëzuara nga OE në rastin e dorëzimit të ofertavene e-prokurim ceket se Prodhuesi Migatronic është me seli në Denmark, DK-9690 Fjerritslev, Aggersundvej 33. E verifikuar edhe nga ne ne ueb faqen www.migatronic.com . Nërsa në ofertën financiare OE ka vendosur vendin e origjines Suedi. Komisoni vlerësues është dashur të kërkojnë infrmacione shtesë në përputhje me nenin 59.2 dhe nenin 72.

Tek specifkacionet teknike dhe katalogjet lidhur me ofrimin e produketeve spas kërkesave në dosjen e tenderit, OE ka nënshkruar një deklaratë ku deklarohet se mallrat e ofruar nga OE Dona – Impex janë në përputhje me Aneksin 1 të specifkacionit teknik të detyrueshëm. AK – dhe komisoni vlerësimit duhet të vlerësojnë specifkacionet teknike sipas LPP nenit 59 dhe specifkacione teknike apo informacione të cilat nuk mund të vlerësohen nga komisoni vlerësues të kërkoj informacione shtese. Mirëpo AK duhet të kërkoj informacione shtesë për dokumentacionin i cili është pjese e aplikimit fillestar, dhe asesi të ndryshoj materialet por materialet ekzistuese vetëm të sqarohen. Ky pretendim **është pjesërisht i bazuar**

Eksperti shqyrtues teknik sqaron që AK dhe komisoni i vlerësimit gjatë procedurës së rivlerësimit duhet të kryejn vlerësim profesional duke respektuar nenët 1, 6, 7, 59, 72 të LPP-së.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet dhe të gjeturat në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet **si pjesërisht të bazuar** dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim** për këtë aktivitet të prokurimit.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues: **Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.**
- Panelit Shqyrtues OSHP
- OE ankues **"Dona-Impex" SH.P.K. – Prishtinë**